



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e premte, në datën 26 nëntor 2021, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Armela</b>	<b>KRASNIQI</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>

AMA pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Ndryshimin e vendimit të dënimit me gjobë, nr. 12, datë 11.10.2021, të grupit të inspektorëve të AMA-s, duke ulur masën e sanksionit nga 2 000 000 lekë, në masën 1 000 000 lekë, vendosur ndaj shoqërisë “Tibo” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet IP (OTT) dhe refuzimin e ankimit administrativ për pjesën tjetër. (**Vendimi nr. 95, datë 26.11.2021**)
2. Miratimin e planit numerik frekuencor për transmetimet numerike tokësore (ku nuk përfshihet brezi DD2). (**Vendimi nr. 96, datë 26.11.2021**)

Gjatë zhvillimit të mbledhjes, 1 prej anëtarëve të AMA-s ndërpreu mbledhjen dhe çështjet e mëposhtme:

- Relacion dhe projektvendim “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Vodafone Albania” sh.a., autorizuar për ofrimin e shërbimeve audiovizive, për miratimin e disa ndryshimeve të paraqitura në kërkesën për marrjen e autorizimit”.
- Relacion dhe projektvendim “Mbi ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Bleta” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet IP (IPTV) “Bleta”,

për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm ligjor për vijimin e mbledhjes së AMA-s (4 anëtarë), shtyhen për në mbledhjen e radhës.

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**Tiranë, më 26.11.2021**